

# SHQIPËRIA ME "BORDIN E ÇUDIRAVE"

## RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2022

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD


[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



AUTOR  
**VALMIRA HOXHA**

## Tabela e përmbajtjes

Hyrja .....	3
Kush është Bordi i Transparencës? .....	3
Vendimet e marra në intervalin kohor Mars-Nëntor 2022 .....	5
Rezultatet e vendimeve të Bordit të Transparencës.....	7
Masat administrative të ndërmarra .....	11
Situata në rajon .....	13
Konkluzione: .....	15
Rekomandime:.....	16



## Hyrja

Nisja e luftës në Ukrainë më 24 shkurt do të trazonte jo pak situatën politiko-ekonomike në Europë dhe jo vetëm. Kjo ishte një ndër arsyt kryesore që çoi në luhatjen e çmimeve të hidrokarbureve dhe produkteve të shportës së konsumit në bursë ku lënda bazë importohet nga këto dy vende tashmë të përfshira në luftë. Abuzimi dhe shfrytëzimi i kësaj situatë nga importuesit dhe zotëruesit të pjesës me të madhe të këtij tregu në Shqipëri bëri që me 12 mars të po këtij viti, Këshilli i Lartë i Ministrave të mbledhë dhe të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme duke cilësuar edhe masat dhe instrumentet që do ndërmerreshin për lehtësimin e kësaj gjendjeje.

Me vendimin e kryeministrit të vendit dhe Këshillit të Lartë të Ministrave do ngrihej Bordi i Transparencës, i cili do kujdesej që të shmangeshin situatat abuzive dhe percaktimin e çmimeve tavan për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. I njëjti instrument do përdorej edhe për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me të.

## Kush është Bordi i Transparencës?

Krijimi i Bordit të Transparencës do të vinte si një ndër instrumentët që do lehtësonin përballimin e situatës së veçantë ekonomike në të cilën vendet e Europës po gjendeshin. Në Mars të këtij viti futet në fuqi vendimi i marrë për ngritjen e këtij bordi dhe kompetencave që do paraqiste (Akti Normativ Nr. 5, Nr.7 dhe Nr 8 botuar në Fletoren Zyrtare). Paraqitet i paqartë fakti se si në këto akte normative janë të specifikuar në mënyrë të detajuar personat që duhet të jenë përgjegjës për monitorimin dhe sigurimin e transparencës e mbarëfungsionimit të tregut të hidrokarbureve dhe ushqimeve bazë të shportës së konsumit, kompetencat e tyre, kur nevojitet ndërhyrja e bordit dhe cilat duhet të ishin masat administrative që do të ndërmerreshin për stabilizimin e situatës ndërkohë që në asnjë dalje publike nuk janë përmendur kush do ishin figurat që do të përfaqësonin këte bord.

Janë bërë monitorime dhe investigime për të evidentuar emrat e anëtarëve të Bordit në bazë të kronikave të ndryshme mediatike, ndonëse nuk ka asnjë publikim zyrtar. Pas dërgimit të kërkesës ndaj Ministrisë së Financave dhe ankimit për mosmarrjen në kohë të një



përgjigjeje, arritëm të zbulonim listën e plotë të anëtarëve të Bordit të Naftës dhe Hidrokarbureve.

Ministria e Financave dhe Ekonomise (MFE)

Znj. Delina Ibrahimaj Kryetar

Z. Nikolla Lera Anëtar

Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë

Znj. Belinda Balluku Anëtar

Z. Enea Karakaçi Anëtar

Z. Ilia Gjermani Anëtar

Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve (DRT)

Z. Ceno Klosi Anëtar

Drejtoria e Përgjithshme Doganave (DRT)

Z. Genti Gazheli Anëtar

Perfaqësues nga shoqëritë hidrokarbure

Z. Sezar Beqaj Anëtar / Kastrati Grup sh.a

Z. Artur Llogoni Anëtar/ Gega Oil Grup sh.a

Z. Agron Bulku Anëtar/ Bolv - Oil sh.a

Z. Gerian Kugi Anëtar/ Euro Petrol sh.a.

Z. Saimir Krasniqi Anëtar/Krasniqi-sh.a.

Absurditeti ndjek çështjen e Bordit të Transparencës që në krijimin e tij e deri në ditët e sotme. Së pari, ndonëse situata paraqitej mëse emergjente, linte hapësira për abuzime në trajtimin dhe përcaktimin e çmimeve të tregtimit të hidrokarbureve dhe krijimi i një strukture të fillë monitoruese dhe kontrolluese ishte e domosdoshme, marzhi i fitimit do i ulej në limitet e tyre me 3 lekë litri për shoqëritë e tregtimit me shumicë, 12 lekë litri për tregtimin me pakicë dhe nga ana e qeverisë nuk do paraqitej asnjë lehtësirë në kuadrin e reduktimit të taksave doganore siç është vepruar nga qeveritë e vendeve të rajonit. Përmendim këtu, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë. Në vendin tone, kostot nga konsumatori do kalonin drejtëpërdrejtë tek importuesi dhe tregtuesi.

Diçka tjetër që tërheq vëmendjen e mbarë publikut është sesi nga Bordi produktet e vetme që caktohen pjesë e shportës së konsumit (produktet ushqimore bazë dhe produkte të lidhura me to) janë vetëm: vaj luledielli, oriz kokerrgjate, miell masiv dhe sheqer. Ishin vetëm këto 4 produkte që u listuan nga bordi si produktet bazë të shportës mbi të cilat do të zbatoheshin situata e veçantë.



## Vendimet e marra në intervalin kohor Mars-Nëntor 2022

**Periudha mars-qershor** përkon edhe me periudhën me luhatjen më të mëdha të cmimit të karburanteve, por gjithashtu edhe më delikaten për shkak të situatës në të cilën Shqipëria dhe shumë vende të Europës po ndesheshin e ndryshimeve të shumta dhe të shpeshta të bursës.

**Tremujori i Dytë** (Mars- Qershor përfshirë edhe periudha e fundit të tremujorit të 1-rë si pasojë e ngritjes së Bordit) na paraqiste këto çmime:

- çmimi i shitjes me pakicë të gazoil gjatë këtij intervali kohor na paraqitet nga 220-261 Lekë/Litri.
- çmimi i shitjes me pakicë të benzines 208-243 Lekë/Litri.
- çmimi i shitjes me pakicë të gazit të lëngshëm të naftës 81-116 Lekë/Litri

### **Tremujori i Tretë (Korrik-Shtator)**

- çmimi i shitjes me pakicë të gazoil 220-243 Lekë/Litri
- çmimi i shitjes me pakicë të benzines 194-235 Lekë/Litri.
- çmimi i shitjes me pakicë të gazit të lëngshëm të naftës 78-81 Lekë/Litri.

### **Situata aktuale (Tetor- Nëntor)**

- çmimi i shitjes me pakicë të gazoil 206-245 Lekë/Litri
- çmimi i shitjes me pakicë të benzines 191-212 Lekë/Litri.
- çmimi i shitjes me pakicë të gazit të lëngshëm të naftës 71-78 Lekë/Litri.

Bordi i Transparencës do ngriej dhe do krijonte strukturën e tij monitoruese dhe kontrolluese edhe për produktet e shportës ushqimore.

Vendimi i parë lidhej me përcaktimin e cilëve prej produkteve do përfshiheshin në këtë kategori si më të predispozuarat për të pasur luhatje çmimesh dhe abuzimesh.

Gjatë intervalit kohor që me shpalljen e situatës së veçantë dhe me rritjen e vazhdueshme të çmimeve, veçanërisht atyre të konsumit janë marrë dhe publikuar vetëm 6 vendime nga Bordi i



Transparencës, ndërkohë që situata vazhdon të jetë mjaft problematike.

### 1.04.2022

Në këtë date daton vendimi i parë i Bordit të Transparencës përsa i përket çmimeve të produkteve bazë të shportës ushqimore. Vlen të përmendet që nga ky bord janë gjykuar vetëm 4 produkte si bazë e shportës së konsumit (miell masiv, sheqer, vaj luledielli dhe oriz kokërrgjatë) në një kohë kur luhatja e çmimeve po prekte mbi 3-fishin e produkteve të përfshira.


- 104 lekë/kg për orizin kokërrgjatë (1 kg). **Marzhi fitimit- 4% mbi çmimin e shitjes me shumicë ose 4 lekë/kg.**
- 123 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit- 3.4 % mbi çmimin e shitjes me shumicë ose 4 lekë/kg.**
- 321 lekë/litër për vajin e lulediellit. **Marzhi fitimit- 1.9% mbi çmimin e shitjes me shumicë ose 6lekë/litër.**
- 90.5 leke/kg për miellin masiv. **Marzhi fitimit- 4.6% mbi çmimin e shitjes me shumicë dhe 4lekë/kg.**

### 29.04.2022

- 109 lekë/kg për orizin kokërrgjatë (1 kg). **Marzhi fitimit 3.8 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 4lekë/kg**
- 121 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit 3.4 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 4 lekë/kg**
- 381 lekë/litër për vajin e lulediellit. **Marzhi fitimit 1.6 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 6 lekë/litër.**
- 79 lekë/kg për miellin masiv. **Marzhi fitimit 5.3 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 4 lekë/kg**

### 04.05.2022

- 109 lekë/kg për orizin kokërrgjatë (1 kg) **Marzhi fitimit 3.8 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 4 lekë/kg.**
- 121 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit 3.4 % mbi çmimin e shitjes me shumic, 4 lekë/kg.**
- 381 lekë/litër për vajin e lulediellit. **Marzhi fitimit 1.6 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 6 lekë/litër.**
- 84 lekë/kg për miellin masiv. **Marzhi fitimit 5 % mbi çmimin e shitjes me shumicë, 4 lekë/kg**



## 10.06.2022

- 101 lekë/kg për orizin kokërrgjatë (1 kg). **Marzhi fitimit 3 lekë/kg mbi çmimin e shitjes me shumicë.**
- 104 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit 3 lekë/kg mbi çmimin e shitjes me shumicë.**
- 90 lekë/kg për miellin masiv. **Marzhi fitimit 2.5 lekë/kg mbi çmimin e shitjes me shumicë**

Marzhi fitimit 4 lekë/litër mbi çmimin e shitjes me shumicë të vajit të lulediellit. Nuk kemi një vlerë të saktë të paracaktuar se sa do të jetë vlera e saktë sa do tregtohej për shkak të situatës jo njëjloj favizuese për te gjithë palët.

## 27.06.2022

- 114 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur.**

## 10.09.2022

- 118 lekë/kg për sheqerin (1 kg). **Marzhi fitimit 3 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur**
- 83 lekë/kg për miellin masiv. **Marzhi fitimit 2.5 lekë/kg mbi çmimin e llogaritur**

<https://financa.gov.al/>

## Rezultatet e vendimeve të Bordit të Transparencës

Ajo çfarë bie më së shumti në sy është zhvillimi i 61 takimeve të kësaj strukture dhe ndër to vetëm 6 ishin përgjegjëse për kontrollimin dhe monitorimin e çmimeve të produkteve bazë të shportës. Situatë e cila u bë alarmante me rritjen e çmimeve të transportit, mungesa në mallrat e importit, pasojat e së cilës vazhdojnë të jenë serioze dhe shkak i shumë abuzimeve.

Në grupin e produkteve ushqimore që do përbenin shportën e konsumit varionin nga 1-4 produkte, në kushtet që një shportë normale varion nga 20-30 produkte.

Mbledhjet janë zhvilluar në mënyrë jo periodike apo në bazë të një kalendarit të caktuar dhe në periudha të largëta kohore. Në aktin normativ shprehet se monitorimi duhet të bëhet çdo javë dhe mbledhjet duhet të regjistrohen online për të cilat gjithashtu informacioni është i cunguar. Bordi gjithashtu ka thyer vendimin në Aktin Normativ Nr.8, duke mos zhvilluar gjatë muajit Tetor takime për 19 ditë.


Vetë ngritja e një strukture dhe marrja e vendimeve nga qeveria ndikon në lirinë e tregut dhe aftësinë e tij vetë-stabilizuese duke kontrolluar edhe marzhet e fitimit.

Vendimet e marra nga Bordi shfaqen në mënyrë indirekte favorizuese ndaj bizneseve (të mëdha) dhe penalizuese për një periudhë kohore të pacaktuar në lidhje me segmente të caktuara të tregut, kryesisht bizneseve të vogla të tregtimit me pakicë. Forcimi i konkurrencës së këtij target-grupi mund të ketë pasoja deri në dalje nga tregu ose falimentim, por njëkohësisht mund të ndikojë rritjen e qarkullimit të parasë informale.

Një problematikë tjetër që paraqitet dhe ndaj të cilës edhe jemi adresuar drejt organeve kompetente për të marrur më tepër informacion është mungesa e transparencës në vetë Bordin e Transparencës. Absurditeti qëndron në faktin se pavarësisht emrit që mbart, transparenca këtu mungon. Nuk ekziston asnjë informacion në rrugë zyrtare, media apo publikime që identifikon emrat e personave përgjegjës dhe kompetencat e secilit për marrjen pjesë në këtë proces vendimor. Përpos Aktit Normativ Nr. 7, datë 18.3.2022 dhe Aktit Normativ Nr.8, datë 25.3.2022 ku specifikohet se kush duhet të jetë pjesë, në vendimet pasuese nuk ka asnjë informacion më të detajuar në lidhje me këtë çështje publikisht..

Një ndër qëndrimet kryesore që është mbajtur krahas vendimit të krijimit të një strukture të tillë dhe vendimeve të tjera pasuese ka qenë cënimi i tregut të lirë. A është tregu ynë i aftë që të bëjë ballë situatave të tilla apo është e domosdoshme ndërhyrja e qeverisë në politika stabilizuese dhe monitoruese? Ngritja e kësaj strukture rezulton diçka e domosdoshme dhe një ndërhyrje e duhur për të mos lejuar rritjen e abuzimeve dhe situatës kaotike të krijuar në vend.

Caktimi i një marzhi fitimi minimal nga 1.5-5% (5-10% marzhi i fitimit në kushte optimale) për shitësit me pakicë përbën një sërë problematikash që prek veçanërisht kategorinë e bizneseve të vogla. Ulja e marzhit të fitimit në minimum çon në vështirësi përballimit të kostove për një biznes të vogël, mund të ndikojë në uljen e ofertës për këtë grup produktesh (gjë e cila sjell efekte në mjedisin ku këto njësi ekonomike operojnë), rritje të çmimeve të produkteve të tjera. Me marrjen e vendimeve nga ana e Bordit të Çmimeve marzhi i fitimit






sa vjen e ulet për kg apo litër të shitur duke reflektuar në një zinxhir efektesh pasuese. Të dy këto elemente ndikojnë jetëgjatësinë e një grupi biznesesh të vogla në treg, duke e bërë të vështirë e në disa raste edhe të pamundur përballimin e kostove dhe konkurrimit me njësitë ekonomike më të mëdha në treg. Një politikë e tillë sjell efekte destabilizuese dhe disfavorizuese më së shumti për tregtarët e shitjes me pakicë.

Rritja e çmimit të produkteve të shportës, energjitikës dhe hidrokabureve ka sjellur rritjen edhe të çmimeve të produkteve tjera të konsumit të përditshëm herë në rrugë direkte dhe herë indirekte. Pavarësisht kësaj kërkesa konsumatore nuk ka pasur luhajtje të mëdha, duke shfaqur një rritje të qëndrueshme edhe në tremujorin e 2-të të këtij viti. Shkak për këtë duket të kenë ndikuar rritja dinamike e punësimit, nivelet e larta të kursimeve dhe paketa e rezistencës sociale.

Faktori i rritjes së vazhdueshme të çmimeve ka pasqyruar efektet e tij në normën e inflacionit. Në muajin tetor të këtij viti, Shqipëria prek normën e inflacionit me 8.3%, më e larta që nga viti 1998. Kategorinë kryesore që ndikuan në indeksin e çmimeve mbi konsumin janë "Transporti" me 16.9% dhe "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 14.6%. Në nënkategorinë e ushqimeve mbizotërojnë "vajra dhe yndyrnat" me 27.4%, "Qumësht,djathë dhe vezë" me 24.3% si dhe "Bukë dhe drithëra" me 17.3%. Në nënkategorinë e transportit vërejmë se peshën më të madhe e zë "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit" me 21.1%.

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Burimi Fig. INSTAT

2 nga 4 produktet e përzgjedhura nga Bordi i Transparencës bëjnë pjesë në kategoritë e mësipërme si më me impakt në rritjen e normës së inflacionit. Një element tjetër është ndryshimi i madh i çmimeve të produkteve që nuk bëjnë pjesë në listën e produkteve të përzgjedhura nga Bordi për mbikëqyrje. Të tilla si “Qumështi, djathi dhe veza”, “ushqimet”. Vlen të theksohet fakti që në muajin shtator dhe tetor, muajt me ndryshimin më të madh të çmimeve përpos marsit të këtij viti, takimi i fundit i bordit për produktet e shportës dhe marrja e një vendimi ka qenë 10 shtator ku përfshiheshin ndryshime në cmimin dhe marzhin e fitimit për sheqerin dhe miellin. Që nga ajo datë nuk ka pasur asnjë përditësim për produktet e shportës.

Në mënyrë indirekte rritja e çmimit të naftës ka ndikuar në uljen e importimit të naftës dhe hidrokarbureve. Në 9-mujorin e fundit sipas të dhënave të nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, importi i naftës dhe hidrokarbureve ka rënë përkatësisht me 9.2%, 0.7% më e ulët edhe nga periodha shtator 2021 pas pandemisë.


Mungesa e një kalendari periodik mbledhesh dhe takimesh ose zbatimi i kësaj te fundit ka rezultuar në mospërputhshmëri midis çmimeve aktuale që gjindeshin në bursë dhe atyre të vendosura nga Bordi. Kjo problematikë është vënë re më së shumti gjatë tremujorit të 3-të të vitit dhe periudhës aktuale (tetor-nëntor). Si rrjedhojë marzhi i fitimit për kompanitë që tregtojnë naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre të jetë i ndryshëm nga ai i parashikuari në vendim dhe jo rrallëherë edhe favorizues ndaj tregëtarëve. Aktualisht çmimi i naftës në bursë rezulton 90\$/fuçi, çmim ky i njëjtë me situatën para luftës ndërkohë që në treg nafta sot figuron me çmimin 232 lekë litri nga 190 që figuronte në periudhën shkurt 2022 duke bërë kështu që nafta të kushtojë rreth 22% më shumë se sa në shkurt për të njëjtin çmim blerjeje.

<http://www.instat.gov.al/al/>

<https://www.monitor.al/cmimet-e-larta-te-naftes-frenojne-konsumin-importet-bien-me-9-2-per-9-mujorin/>

<https://www.monitor.al/cmimet-nuk-ndalen-inflacioni-arrin-8-3-ne-tetor-tjeter-rekord-qe-nga-koha-e-piramidave/>

[https://youtu.be/k\\_jmKkEFZIs](https://youtu.be/k_jmKkEFZIs)



## Masat administrative të ndërmarra

Me nxjerrjen e dy akteve normative nr.7, dt 18.03.2022 dhe nr.8, dt.25.03.2022 bëhen të njohura edhe masat administrative që do ndërmerreshin në raste shkeljeje.

Në rastin e abuzimeve me çmimet e vendosura nga Bordi i Transparencës mbi produktet ushqimore bazë dhe produkte të tjera të nderlidhura me to, në aktin normativ nr.7 datë 18.03.2022, neni 7 jepen masat administrative të veçanta që do zbatohen në rast shkeljeje.

Mosrespektimi i marzhit të fitimit të vendosur nga Bordi për produktet ushqimore baze dhe të tjera të ndërlidhura, subjektet e tregtimit me shumicë do dënoheshin me gjobë, në masën 10 milionë lekë. Subjektet e tregtimit me pakicë në rast konstatimi shkeljeje do gjobiteshin në masën 2 milionë lekë. Përsëritja e abuzimeve apo shkeljeve rezultonte deri në pezullim apo sekuestrim të produkteve në gjendje inventari.

Neni 21/6 në Aktin normativ nr 8, date 25.03.2022 parashtrohet masat administrative të veçanta për mosrespektimin e vendimeve të marra nga Bordi i Transparencës mbi "Përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".

Në rast mosrespektimi të çmimit tavan të vendosur nga Bordi, ndaj shoqërive të tregtimit me shumicë dhe pakicë merret vendimi i pezullimit të licencës së ushtrimit të veprimtarisë për 3 muaj dhe detyrim për mosndryshimin e gjendjes së produkteve të naftës dhe gazit. Nëse edhe gjatë pezullimit të licencës konstatohet se shoqëria ka vazhduar të zhvillojë aktivitetin, merret masa administrative e heqjes së licencës dhe sekuestrim të stacionit të shitjes së karburantit. Rezultimi se edhe pas mbarimit të masës së pezullimit, subjekti kryen shkelje të vendimeve nga Bordi, ushtrohet masa administrative e heqjes së licencës dhe sekuestrimi i stacionit të shitje së karburantit.

Situata qëndron e paqartë kundrejt faktit se sa masa administrative janë ndërmarrë konkretisht në interval kohor mars-nëntor 2022. Kjo periudhe dhe ngritja e këtyre strukturave duhej të shërbente jo vetëm për kontrollin e çmimeve por edhe monitorimin e zbatueshmërisë së tyre, një ndër elementët kyç të vetë krijimit të Bordit. Publikimet e monitorimet e bëra në terren në njësi ekonomike kanë qenë më së tepërmi në rrugë informale apo nga kronikat mediatike dhe emisionet investigative.


Informacioni i publikuar nga institucionet përkatëse në lidhje me këtë çështje është i munguar. Në regjistrat e kërkesë-përgjigje të institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti i Konkurrencës apo Inspektoriatit Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut nuk figuron asnjë kërkesë në 9 muajt e fundit mbi marrjen e një informacioni për shkeljet dhe masat e marra dhe asnjë vendim mbi raportimin e monitorimit dhe rastet e shkeljeve të vendimeve.

Qëndresa Qytetare ka derguar një numër kërkesash për informacion në lidhje me informimin mbi rastet e shkeljes dhe masat administrative të ushtruara. Ministria e Finances i janë përgjigjur kërkesës për informacion pas ankimit duke u shprehur se:

“Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 21/8 të aktit normativ nr. 8, datë 25.03.2022 “Për disa shtesa në Ligjin 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me Vendimin Nr. 13, datë 06.04.2022, **ka vendosur për dhënien e masën administrative ndaj subjektit "Bregu Oil" sh.p.k., me Nipt-L42823001F “Pezullim liçense për 3 muaj për ushtrim veprimtarie dhe detyrimin për mosndryshimin e gjendjes së produkteve të naftës dhe gazit”.**

Në referencë të pikës 3 të nenit 21/8, të Aktit Normativ nr. 8, datë 25.03.2022 “Për disa shtesa në Ligjin 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, vendimi në referencë i është dërguar për ekzekutim Inspektoriatit Shtetëror Përgjegjës, pranë Mnistristrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Njesisë Administrative Cukalat, Bashkia Dimal, Qarku, Berat.

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, **nuk ka marrë asnjë masë administrative për periudhën Mars – Tetor 2022”.**



## Situata në rajon

Ndonëse çmimet e energjistikës dhe të grurit kishin nisur të pësonin rritje që në shtator të 2021 dhe shumë vende kishin nisur të hartonin politika për reduktimin e pasojave dhe mbajtjen në kontroll të normës së inflacionit, impakti që këto dy shtete kanë në ekonominë botrore është i mjaftueshëm për të krijuar kaos në bursë dhe në ekonomitë kombëtare. Politikat sanksionuese ekonomike që vendët po ushtronin si kundërpërgjigje e sulmeve qenë një ndër shkaqet kryesore të destabilitetit që u krijua në ekonominë mbarëkombëtare.

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor në të cilin bën pjesë edhe Shqipëria, efektet e luftës vinin si një zinxhir efektesh në ekonominë dhe tregjet europiane. Një ndër politikat e ngjashme që ndjekën vendet e rajonit ishte fiksimi i çmimeve përkohësisht dhe ulja e marzhit të fitimit deri në zero për një periudhë kohore të përcaktuar. Shqipëria ngriti strukturën e Bordit për monitorim dhe përcaktim të çmimeve tavan ku marzhi i fitimit për produktet ushqimore si vaji lulediellit, sheqeri, mielli dhe orizi nuk kalonte 5% dhe në vendimet e fundit ulen deri në 1.6% në disa produkte. Serbia vendosi masë për fiksimin e çmimeve të miellit, sheqerit, vajit të lulediellit, mishit të derrit dhe qumështit dhe ndalimin e eksportit të disa produkteve bazë. Kosova uli marzhin e fitimit në 6% për shitjen me pakicë të naftës dhe 4% për shitjen me shumicë. Mali i Zi ndryshe nga vendet e tjera të rajonit ndjeku politikën e uljen e akcizës së karburantit për 20%, miratoi vendimin për rritjen e stoqeve të ushqimit dhe karburanteve, si dhe krijimin e rezervave të mallrave që mungote në vend që nga viti 2003. Maqedonia e Veriut ka qenë gjithashtu një nga shtetet që ka përdorur politikën e reduktimit të tarifave doganore dhe duke ulur normën preferenciale të TVSH-së për produktet ushqimore bazë nga 5% në 0%. Kjo vlente për produktet bazë si buka, sheqeri, mielli, vaji i lulediellit, qumështi, mishi i freskët, orizi dhe vezët. Kjo politikë u shoqërua gjithashtu edhe me ngirjen e marzheve për disa produkte bazë për periudhën prill-qershor.

Vendimet e fiksimit të çmimeve ose marzhit për secilin nga vendet fqinje, vërejmë se është treguar një kujdes i veçantë për të dy palët e prekura: familjet si konsumatorë dhe bizneseve. Është treguar kujdes ndaj mbajtjes së marzhit jo më të vogël se 4% dhe uljen e taksave doganore apo TVSH-së.

Një tjetër politikë e përbashkët midis vendeve të rajonit është edhe paketa e krizës. Maqedonia kryeson në rajon me një vlerë mbi 615 milion euro, Greqia 500 milion euro, Shqipëria 200 milion euro, Kosova mbi 110 milion euro. Në muajin shtator janë publikuar edhe paktetat e dyta anti-krizë ku ajo e Kosovës mbante vlerën e mbi 150 milionë euro



dhe e Shqipërisë 52 milionë euro. Këto paketa kishin si pikësynim reduktimin e normës së inflacionit të stimuluar nga rritja e konsiderueshme e çmimeve në treg.

Një ndër faktorët që tërheq më së shumti vëmendjen është alokimi i resurseve dhe burimeve nga vendet fqinje. Paketat e anti-krizës në Maqedoni apo Kosovë kanë një shtrirje më të gjërë dhe eficiente përsa i përket alokimit në kategoritë që do mbështeten nga kjo paketë dhe vlerës specifike.

### PAKOJA PËR PËRBALLJE ME INFLACION



- \* SUBVENCONIM I FATURËS SË RRYMËS PËR ATA QË KURSEJNË ENERGIJË ELEKTRIKE
- \* PROJEKTILIGJI PËR PUNË PUBLIKE PËR KOMPENSIMIN E INFLACIONIT PËR MATERIALE NDËRTIMORE DHE PUNË PËRCJELLËSE
- \* DYFISHIM I NJËHERSHËM I SHUMËS SË ASISTENCËS SOCIALE PËR MUAJIN SHTATOR
- \* 100 EURO MBËSHTETJE E NJËHERSHME PËR PENSIONISTË
- \* 100 EURO MBËSHTETJE E NJËHERSHME PËR STUDENTË
- \* 100 EURO MBËSHTETJE E NJËHERSHME PËR PUNËTORË TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
- \* 50 EURO SHITESË PËR PUNËTORË TË SEKTORIT PUBLIK NGA MUAJI SHTATOR
- \* SUBVENCONIM PREJ 50% TË RRITJES SË PAGËS DERI NË 100 EURO PËR PUNËTORË TË SEKTORIT PRIVAT, PËR 3 MUAJT E PARË


**RRETH 150 MILIONË EURO TJERA PËR 300 MIJË FAMILJE DHE RRETH 600 MIJË QYTETARË**

Në një raportim të Euronews Albania të bërë në muajin Shtator, në bazë të disa të dhënave të publikuara nga Banka Botërore, Shqipëria rezulton si vendi me rritjen më të ulët të çmimeve në rajon. Pasojë për këtë ka qenë rritja e normës së inflacionit për vendet e rajonit si Kosova, Mal të Zi, Bullgari, Maqedoninë e Veriut dhe Bosnjë, shënonte 24% në muajin korrik, ndërsa në Shqipëri 15% (norma e inflacionit për ushqimet).

<https://vlada.mk/node/28088?ln=sq>


<https://top-channel.tv/2022/03/02/lufta-dhe-nafta-kosova-fikson-cmimin-per-te-ruajtur-konsumatoret-nga-luhatjet/>

<https://shqiptarja.com/lajm/kosova-pakete-ndihme-kundwr-inflacionin-100-euro-per-pensionistet-2fishim-i-asistences-sociale-shperblim-i-qytetaret-ge-kursejne-energji>




## Konkluzione:

- Për të përcaktuar nevojën aktuale për ekzistencën e Bordit të çmimeve duhet të analizohet paraprakisht dobishmëria që ky bord kishte dhe impakti në lehtësimin e përballimit të krizës në vend. Efektiviteti i një strukture të tillë, muajve të fundit ka lënë hapësirë për diskutime të shumta. Dy funksionet bazë dhe arsyet e krijimit ishin monitorimi i situatës në treg dhe parandalimi i abuzimeve duke favorizuar konsumatorin. Monitorimi i situatës në treg qoftë për çmimet e naftës dhe gazit, qoftë te çmimeve të produkteve bazë ushqimore duhej të bëhej çdo javë sipas akteve respektive normative, ndërkohë që shpeshherë ka pasur shkelje.
- Mungojnë raportet apo publikimet që mundësojnë informimin publikut mbi gjendjen e monitorimit për periudhën mars-nëntor.
- Vendimet e marra nga Bordi në të shumtën e rasteve nuk kanë qenë koherente dhe të marra në kohë direkte me ndryshimet e ndodhura në bursë, duke bërë kështu që të krijohen hapësira për abuzim dhe favorizim nga ana e bizneseve të mëdha.
- Pavarësisht publikimit të rasteve të abuzimit në media apo programe investigative, nuk është marrë apo publikuar asnjë vendim mbi mosrespektimet e vendimeve të marra nga Bordi i Transparencës dhe ushtrimi i masave administrative.
- Në një situatë të tillë duket sikur zhvillimi i kësaj politike për përballimin e krizës ka pasur më shumë probleme në ekzekutimin e saj sesa kontribut në komunitet. Në hapat e parë frenoi shkallën e lartë të abuzimit që po bëhej nga shoqëritë që zotëronin pjesën më të madhe të tregut duke vendosur çmime "karteli".
- Aspekt pozitiv si rezultat i ngritjes së bordeve qëndron tek mbajtja në kontroll e normës së inflacionit, si pasojë e ngrirjes së marzhit të fitimit për një çmim të caktuar.
- Mbledhjet nuk kanë qenë periodike veçanërisht për Bordin mbi produktet bazë ushqimore. (struktura është në fuqi deri në deklarimin e përfundimit të situatës së veçantë). Mbledhja e fundit e mbajtur për monitorimin e çmimeve të shportës së konsumit ka qenë në shtator të këtij viti. Kjo gjë na bën të kuptojmë që edhe pse në nivelet më të mira të mundshme tregu ja ka dalur mbanë të mbajë të stabilizuar situatën e çmimeve përse i përket këtij sektori që nga periudha shtator-nëntor.



## Rekomandime:

- Situata e veçantë e pasojave të luftës duket se po i lë vendin asaj të inflacionit. Hapi më efektiv dhe i cili nuk do cënonte as lirinë e tregut dhe as bizneset e vogla dhe konsumatorët do ishte forcimi dhe mirëfunksionimi i organeve që janë kompetente për monitorimin e situatës së tregut. Autoriteti i Konkurrencës, Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë kapacitetet dhe kompetencat e mjaftueshme për të hartuar, monitoruar, mbikëqyrur dhe ekzekutuar politikat, vendimet dhe masat administrative që duhet të zbatohen pa pasur nevojën e ekzistencës më të një Bordi.
- Sipas publikim të fundit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, krahasuar me një vit më parë të ardhurat janë rritur me +60.6 miliard lekë ose +14.6% më shumë. Të ardhurat nga TVSH-ja në import, taksat doganore, kanë pësuar rritje me 24.6% dhe 19% më shumë se vitin 2021. Një nga faktorët që ka ndikuar në gjenerimin e më shumë të ardhurave për këto kategori është rritja e çmimeve në 10 mujorin e fundit. Alokimi i këtyre të ardhurave dhe kthimi i tyre në investime për kategoritë e prekura më së shumti nga situata aktuale do të ishte një ndihmesë në përballimin e pasojave të rritjes së çmimeve dhe normës së lartë të inflacionit.
- Nisur nga impakti i drejtëpërdrejtë që pati rritja e çmimeve në rritjen e normës së inflacionit në vlera me të cilat ekonomia e vëndit tonë nuk ishte përballur që në 1998, është e nevojshme hartimi i paketave antikrizë më gjithëpërfshirëse si dhe në një vlerë totale më të lartë se ajo e mëparshme. Kjo paketë duhet të jetë e përshtatur në vlerë me kontributin apo ndihmesën që do i japë çdo kategorie duke pasur parasysh që kostoja e jetesës aktualisht në Shqipëri është shumë herë më e lartë seç ka qenë një vit më parë.





#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)